

UDHËZIM
Nr. 7, datë 21.2.2025

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 18.7.2024,
“PËR RREGULLAT PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR
ÇRRËNJOSJEN DHE PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË *GLOBODERA PALLIDA*
(GURIT) BEHRENS DHE *GLOBODERA ROSTOCHIENSIS* (WOLLENWEBER)
BEHRENS¹”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 21, datë 18.7.2024, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 13 shfuqizohet.

2. Në aneksin III, shkronja “b”, të pikës 1, bëhen ndryshime si më poshtë:

a) shkronja “ii” ndryshohet me formulimin si vijon:

“ii) izolimi i cistëve *Globodera* nga mbetjet bazuar në morfologjinë e cistit, i ndjekur nga identifikimi i specieve bazuar në morfologjinë e cistëve individuale dhe të vegjlit (*juveniles*), i kombinuar me *real-time PCR*, bazuar në *Gamel et al.*, 2017 ose *real-time PCR*, bazuar në *Lombard et al.* 2024^(*)”;

b) pas shkronjës “iii” shtohet pika “iv” me këtë përmbajtje:

“iv) izolimi i cistëve nematode nga mbetjet bazuar në morfologjinë e cistëve, i ndjekur nga zbulimi dhe identifikimi i specieve, bazuar në *real-time PCR*, të cistëve të qëndrueshme (*viabile*) dhe të vegjlit (*juveniles*) të gjallë bazuar në *Lombard et al.* 2024”.

(*) Lombard L, Dekker-Nooren CCEM, Wuijster B, van Kessel, SP, van Duivenbode I, van Bruggen AS, van Heese EYJ (2024), Krahësimi i efektivitetit të *real-time PCR*-ve për të treguar dhe për të treguar sigurinë. *Globodera pallida* dhe *G. rostochiensis*. Eur J Plant Pathol, <https://doi.org/10.1007/s10658-024-02864-7>.

3. Aneksi IV zëvendësohet me aneksin bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

¹ Ky udhëzim përaftron plotësisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2024/2060, e datës 30 korrik 2024 për ndryshimin e rregullores zbatuese të Komisionit (BE) 2022/1192, në lidhje me modelin për vërtetimet e *Globodera pallida* (Gurit) Behrens dhe *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens, përdorimin e metodave të testimit dhe përcaktimin e vendndodhjeve të prodhimit të infektuar.

ANEKSI IV

Modeli i vrojtitimit referuar në nenet 3 dhe 6

Modeli për paraqitjen e rezultateve të vrojtimit të nematodes së cisteve të patates të kryera gjatë vitit kalendarik që i paraprin vitit të raportimit. Tabela e mëposhtme përdoret vetëm për patatet e korrura në vendin tonë.

[illegible]

⁽¹⁾ E rëndësishme vetëm në rastin e vrojtimeve monitoruese.

⁽²⁾ Shkalla e mostrimit në kuptimin e aneksit III të udhëzimit nr. 21, datë 18.7.2024 (kryesisht e përcaktuar nga madhësia e mostrës); përdorni një rresht individual për çdo normë mostrimi, përkatësisht.

⁽³⁾ *Globodera pallida*.

⁽⁴⁾ *Globodera rostochiensis*.

⁽⁵⁾ Sipërfaqja totale e zonës së infektuar në vitin, para vitit të mbuluar nga raporti.

⁽⁶⁾ Sipërfaqja totale e zonës së infektuar në vitin e mbuluar nga raporti.

⁽⁷⁾ Asnjë vrojtım zbulimi nuk kërkohet për mbjelljen e patateve të destinuara për prodhimin e zhardhokëve të patates që do të përdoren brenda të njëjtıt vend të prodhimit që ndodhet brenda një zone të përcaktuar nga AKVMB-ja.

⁽⁸⁾ Asnjë vrojtım zbulimi nuk kërkohet për mbjelljen e bimëve të aneksit I të destinuara për rimbjellë brenda të njëjtıt vend prodhimi që ndodhet brenda një zone të përcaktuar nga AKVMB-ja dhe për bimët e renditura në pikat 2 dhe 3, të aneksit I, të destinuara për rimbjellë, kur bimët e vjela do t'u nënshtrohen masave të miratuara zyrtarisht të përmendura në pikën 1 të aneksit II.